



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 64 par.2 pika a) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes, nxjerr

### VENDIM

#### MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR PROJEKT – RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

##### Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës dhe në Tabelën e Shpalljeve:

Projekt-Rregullorja për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

##### Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Projekt Rregullore mund ti dërgohen duke ja drejtuar Komisionit për hartimin e Projekt – Rregullorës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës më së largu deri më datë 07.12.2020.

##### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

1Nr. 463 - 55049  
Lipjan, më 05.11.2020

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

